



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 073/22
Data: 16.02.2022

Prishtinë, 07 shkurt 2022
Kodi i ZRRE: V_1485_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Nenit 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 27 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat ligjore të Rregullës ZRRE/Nr.05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së);
- Vendimin e ZRRE-së Nr. V_1027_2018 të datës 24 shtator 2018, lidhur me aprovimin e të hyrave të Lejuara Maksimale për periudhën e dytë rregullative 2018-2022, për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Njoftimin e ZRRE-së Nr. 643/21 të datës 13.12.2021 për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut OST/OT, Nr. V_1484_2022;
- Aplikacionin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes – OSSH (KEDS SH.A) për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, të dorëzuar më datën 28 dhjetor 2021;

në seancën e mbajtur më 07 shkurt 2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (HLM) që do të mblidhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përmes tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes, nga data 09.02.2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mblidhen nga OSSH për vitin relevant tarifor 2022 do të jenë 179,555,073 Euro.**

- III. Operator i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) duhet t'i përgatisë dhe dorëzojë për aprovim në ZRRE tarifën për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes bazuar në HLM të OSSH-së, sipas këtij Vendimi.
- IV. Tarifat e propozuara nga OSSH duhet të jenë në përputhje me Metodologjinë e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Metodologjinë e Taksave për Kyçje në OSSH, të aprovuara nga ZRRE.
- V. Ky vendim do të zbatohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duke filluar nga data 09 shkurt 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13 dhjetor 2021 ka iniciuar Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, duke përfshirë edhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- o ZRRE sipas njoftimit të saj, ka vlerësuar se ekzistojnë argumente të qarta dhe në bashkërendim me procesin e fundit tarifor, ka konstatuar se ka indikacione të tejkalimit të pragut të materialitetit prej 5 % në të Hyrat e Lejuara Maksimale të operatorëve të rregulluar të energjisë elektrike.
- o ZRRE në vazhdimësi ka monitoruar situatën e furnizimit me energji elektrike dhe nga analizat e bëra, ka konstatuar se si pasojë e mbizotërimit të çmimeve të larta të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare, është rrezikuar siguria e furnizimit për konsumatorët fundorë me energji elektrike. Duke qenë se kostot e blerjes së energjisë me shumicë janë jashtë kontrollit të operatorëve, konform kornizës ligjore të rregullimit, ZRRE ka iniciuar shqyrtim të jashtëzakonshëm të HLM për operatorët e rregulluar, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së furnizimit për konsumatorët e energjisë elektrike dhe reflektimit të kostove të furnizimit.
- o Prandaj, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, ka hapur shqyrtimin e jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH.
- o ZRRE më datë 28 dhjetor 2021 nga OSSH ka pranuar aplikacionin për të Hyrat e Lejuara Maksimale.
- o ZRRE më datë 17 janar 2022 ka publikuar Raportin Konsultativ-Shqyrtim i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- o Raporti Konsultativ ka paraqitur qëndrimet e ZRRE-së, për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave për të mbuluar ndryshimin e ndjeshëm në kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe për të rivendosur furnizimin me energji elektrike për konsumatorët, si dhe raporti është publikuar krahas një raporti tjetër konsultativ që synon të marrë qëndrimet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së për ndryshimin e strukturës tarifore për të rritur eficiencën e konsumit të energjisë elektrike.

- ZRRE, gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka dorëzuar komente më datë 27 janar 2022 ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar.
- Raporti përfundimtar i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm të Hyrave të Lejuara Maksimale për operatorët e Rregulluar, përfshirë edhe OSSH-në, përfshinë vlerësimet përfundimtare dhe përgjigjet në komente te palëve të interesit dhe i njëjti është publikuar në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- ZRRE ka vlerësuar se, për qëllime tarifore ka përdorur qasjen e njëjtë sikurse në vitet e kaluara, që do të thotë se në kalkulimet e saj nuk merr në konsideratë tejkalimin e humbjeve mbi ato të lejuara me Shqyrtimin Periodik 2018-2022. Për më tepër, OSSH duhet të kuptojë që përmes humbjeve të tejkaluara shkakton ngarkesë shtesë në sistem, andaj përveç që duhet të bartë koston për blerjen e energjisë për tejkalimin e humbjeve, duhet të përmirësojë gjendjen e rrjetit në atë nivel që ofron siguri të furnizimit dhe ulë koston e përgjithshme të sistemit. Andaj ZRRE nuk mund të bartë tek konsumatorët një barrë shtesë e cila vjen si rezultat i tejkalimit të humbjeve në OSSH.
- Poashtu ka trajtuar edhe kostot e blerjes së humbjeve dhe çmimet e importit të energjisë elektrike, ku ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar të dhënat e realizuara të konsumit të energjisë për muajin janar 2022, të cilat në vlerësimin fillestar ishin si parashikim në bazë të verzionit 0.4 të Bilancit të Energjisë. Duke u bazuar në Rregullën e të Hyrave të OSSH-së, ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka njohur realizimet e konsumit për muajin janar 2022, rrjedhimisht edhe koston e realizuar të humbjeve sipas nivelit të lejuar gjatë Shqyrtimit Periodik.
- Gjithashtu ka vlerësuar se, Konsumi i energjisë elektrike gjatë muajit janar 2022 kishte pësuar rritje prej rreth 8% në raport me parashikimin. Duke i shtuar kësaj edhe rënien e njësisë B2 të KEK-ut, sistemi kishte rritur varësinë në masë të ndjeshme nga importi i energjisë elektrike. Fillimisht ishte planifikuar që gjatë muajit janar 2022, OSSH të blinte 79.9 GWh energji elektrike nga KEK-u, derisa blerjet e realizuara nga KEK gjatë muajit janar ishin vetëm 8.4 GWh. Mungesa e energjisë nga KEK-u prej rreth 71.5 GWh është zëvendësuar me import me një çmim mesatar të realizuar prej 227.9 Euro/MWh. Kosto e importit të energjisë elektrike nga OSSH për muajin janar arrin në 28.7 milion euro, dhe si rezultat i tyre është vlerësuar se ka një ndryshim të koston së humbjeve në Sistemin e Shpërbërjes nga 99.6 milion euro në 106.65 milion euro. Çmimi mesatar i parashikuar për blerjen e energjisë nga OSSH për vitin relevant tarifor 2022 rezulton në 115.6 euro/MWh, i cili përbën mesataren e ponderuar nga çmimi vendor dhe ai i importit. Çmimi i importit është kalkuluar në bazë të pjesëmarrjes së tij gjatë kohës së pikut dhe jashtë pikut, ku ka ardhur në përfundim se nga të gjitha komentet ndaj të Hyrave të OSSH-së, vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së për vitin relevant tarifor 2022, është 179.56 milion Euro.

- o Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hpti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buça, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe Arkivit të ZRRE-së.